



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 63, datë 24.07.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. VLADIMIR GËRMENJI NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës 17.07.2019 dhe 24.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR GJYQATAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Z. Vladimir Gërmenji

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të **z. Vladimir Gërmenji**, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Vladimir Gërmenji.
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Arta Marku.

7. Z.Vladimir Gërmenji, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Vladimir Gërmenji, gjendet e administruar në dosjes e kandidimit.

8. Në datën 09.04.2019, kandidati Vladimir Gërmenji është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen kandidimit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Vladimir Gërmenji ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Vladimir Gërmenji, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 2854/4 prot., datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Vladimir Gërmenji e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, të Ligjit nr. 9049/2003 dhe Ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 8/31 prot., datë 29.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Vladimir Gërmenji dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatis Vladimir Gërmenji dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatis Vladimir Gërmenji, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easy pay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit EVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Vladimir Gërmenji.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 28.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidatin Vladimir Gërmenji për

të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që vlerëson të paraqesë në mbështetje të shpjegimeve të tij.

18. Kandidati Vladimir Gërmenji, në datën 03.06.2019, ka depozituar pranë Këshillit shpjegimet përkatëse duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Vladimir Gërmenji sipas Ligjit nr. 138/2015.

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/212 prot., datë 31.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Vladimir Gërmenji.

21. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Vladimir Gërmenji, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 120 prot., datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 114 prot., datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 118 prot., datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 117 prot., datë 17.04.2019*).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat nr. 1545 prot., datë 10.06.2019 dhe nr. 680/1 prot., datë 15.05.2019, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidatin Vladimir Gërmenji.

24. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidati Vladimir

Gërmenji për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 551/1 prot., datë 03.05.2019 ka dërguar Vendimin nr. 271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Vladimir Gërmenji.

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Vladimir Gërmenji në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Vladimir Gërmenji.

28. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna dhe gjetje që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja raportore e Këshillit znj. Arta Marku ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z. Vladimir Gërmenji, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

30. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidati Vladimir Gërmenji.

31. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

32. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

33. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

34. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Vladimir Gërmenji.

35. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtrroi se:

- ka mungesë dokumentacioni në dosjen e dërguar pranë Avokatit të Popullit që vërteton plotësimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore,

- lidhur me pasurinë, janë evidentuar probleme në deklarimin e pasurisë nga ILDKPKI, për të cilat janë kërkuar shpjegime me shkrim kandidatit, por në relacion mungon analizë lidhur me gjetjet e KED sa i takon procesit të verifikimit të pasurisë. Në çdo rast shpjegimet lidhur me plotësimin e detyrimeve tatimore përgjatë disa viteve nuk janë në përputhje me ligjin e kohës, konkretisht pagesën e detyrimeve në formën e thjeshtuar por mbi bazën e xhiros progresive reale të fundvitit.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

36. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Vladimir Gërmenji për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

37. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

38. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

39. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 37 dhe 38 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

40. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbente motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

41. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin Vladimir Gërmenji, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 7/a pika 1 shkronja “dh” Ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

42. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të Ligjit nr. 115.2015, të Ligjit nr. 9049/2003 dhe

Ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr. 6/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatit Vladimir Gërmenji dhe personat e lidhur me të.

43. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Vladimir Gërmenji, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

44. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Është deklaruar apartament banimi me sipërfaqe 75 m², Rr. “K.L.”, Pallati (***) , Shkalla (***) , apartamenti (***) , Tiranë, i blerë me datë 01.11.1996, me vlerën 1.800.000 Lekë, me pjesë takuese 50%. Burimi i krijimit është deklaruar shitja e apartamentit në Shkodër me datë 04.11.1996 në vlerën 1.200.000 Lekë dhe kursime familjare të dy bashkëshortëve në vlerën e shtuar prej 600.000 Lekë;
- Është deklaruar apartamenti me sipërfaqe 50.7 m², Rruga “M.Gj.”, pallati(***) , Tiranë, blerë me date 28.08.2001, me vlerën 1.900.000 Lekë, me pjesë takuese 50 %, me burim krijimi të ardhurat nga puna si avokat dhe kursime familjare;
- Është deklaruar apartament sipërfaqe 46.13 m², i ndodhur në “Kryemëdhenj” Kavajë, blerë me datë 29.12.2005, me pjesë takuese 50 %, me burim krijimi të ardhurat nga puna si avokat dhe kursimet familjare të të dy bashkëshortëve;
- Është deklaruar apartament me sipërfaqe 62.37 m², i ndodhur në Linzë, ish-Komuna Dajt, Tiranë, blerë me datë 08.12.2007, me vlerë 2.000.000 Lekë, me pjesë takuese 50%, me burimi të krijimit të ardhura nga puna si avokat dhe kursime familjare;
- Është deklaruar apartament me sipërfaqe 74 m², i ndodhur në lagjen “10 Korriku”, Vlorë, blerë me datë 05.05.2009, me vlerë 4.000.000 Lekë, me pjesë takuese 50 %, me burim krijimi kredi bankare nr. 47, datë 07.01.2008, në shumën 30.000 Euro, e shlyer sipas deklaratës noteriale me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 10.12.2012, me këst mujor 560 Euro;
- Është deklaruar nga z. E.G. dhe znj. M.S. një kontratë ku ato dalin si blerës të ardhshëm, me palë shitëse premtuese znj. S.B., apartamenti me sipërfaqe 100 m², sipas kontrates premtim shitje me nr. (***)rep., nr. (***) kol., me datë 07.01.2019, me vlerë totale 130.000 Euro, ku aktualisht është paguar shuma 90.000 Euro nëpërmjet Fibank sh.a., në pjesë takuese 50% me 50 %, me burim krijimi kontrata e dhurimit me nr. 56 rep., nr. 12 kol., datë 07.01.2019, me dhurues z. Vladimir Gërmenji në shumën 3.000.000 Lekë, shumë kjo që vjen nga asistenca e ofruar nga studio avokatisë Gërmenji, Organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, me vlerën 4.230.000 Lekë; kontrate dhurimi me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 07.01.2019, me dhurues znj. G.S. dhe pranuese dhurimi znj. M.S., në shumën 2.000.000 Lekë; të ardhura nga puna si avokat që nga vitit 2005 e në vijim si dhe shpërblime të tjera mujore nga avokati Vladimir Gërmenji, në totale në shumën 40.000 në muaj; të ardhura nga puna në biznes të znj. M.S., sipas NIPTIT.

Në përfundim të kontrollit të ILDKPKI, rezultoi:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të shumës 600.000 Lekë e përdorur si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 75 m² në Tiranë;
- Lidhur me burimin financiar të shumës 1.900.000 Lekë e përdorur për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 50.7 m² në Tiranë, rezulton se subjekti ka patur qarkullim nga aktiviteti privat “Avokat”, por është i paqartë fitimi i realizuar;
- Lidhur me burimin financiar të shumës 1.800.000 Lekë e përdorur për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 46.13 m² në Kavajë, rezulton se subjekti ka patur qarkullim nga aktiviteti privat “Avokat”, por është i paqartë fitimi i realizuar;
- Lidhur me burimin financiar të shumës 2.000.000 Lekë e përdorur për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 62.37 në Tiranë, rezulton se subjekti ka patur qarkullim nga aktiviteti privat “Avokat”, por është i paqartë fitimi i realizuar;
- Është i paqartë burimi financiar i shumës 4.000.000 Lekë përdorur për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 74 m², në Vlorë, pasi subjekti ka deklaruar si burim kredi bankare në shumën 30.000 Euro, ndërkohë të kontratën e kredisë përcaktohet qëllimi “blerje/rikonstruksioni i një apartamenti me adresë “Linzë, Tiranë”, ndërsa rezulton se kredia është disbursuar në datë 11.02.1008 dhe në të njëjtën datë ka kaluar si transaksion me përshkrim “pagesë” për blerje apartamenti, por shuma i ka kaluar shoqërisë D. sh.p.k. për blerje apartamenti dhe jo shoqërisë shitëse A. sh.p.k.;
- Është i paqartë burimi financiar i përdorur për blerjen e automjetit me targa (***) në datë 07.01.2009 në shumën 6000 Euro, pasi subjekti ka deklaruar si burim shitjen e një automjeti tjetër, por rezulton se ky automjet është shitur në datë 16.06.2010 (rreth një vit e gjysmë më vonë);
- Lidhur me vlerën e automjetit me targë (***), subjekti ka deklaruar vetëm shumën 6000 Euro, ndërkohë rezulton se subjekti ka paguar edhe shpenzime doganore në shumën 448.188 Lekë;
- Rezultojnë mospërputhje lidhur me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat “Avokat” për vitin 2013 dhe 2015, pasi referuar DRT Tiranë subjekti për këto vite ka realizuar qarkullim në shumat 645.834 Lekë dhe 908.427 Lekë, ndërsa referuar shkresës së Shoqatës SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri, për vitin 2013 shuma e faturuar është 7400.000 Lekë dhe për vitin 2015 shuma 960.000 Lekë;
- Është i paqartë fitimi i realizuar nga aktiviteti privat “Avokat” për periudhën 1998 – 2007, pasi DRT Tiranë dhe Bashkia Tiranë për këtë periudhë konfirmojnë vetëm qarkullim dhe jo fitim;
- Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për vitin 2015 nga aktiviteti privat “Avokat” qarkullimi është në shumën 1.450.567 Lekë, shpenzime në shumën 1.300.000 Lekë, fitim në shumën 150.567 Lekë dhe ka paguar tatim në shumën 25.000 Lekë, ndërsa referuar DRT Tiranë, për vitin 2015 qarkullimi është në shumën 908.427 Lekë, shpenzime 289.456 Lekë, fitim në shumën 618.971 Lekë dhe tatimi i thjeshtuar në shumën 25.000 Lekë;
- Lidhur me shumën 3.000.000 Lekë e përdorur si burim për apartamentin e banimit me sipërfaqe 100 m² në Tiranë, rezulton e deklaruar se kjo shumë është përfutuar nga asistenca e ofruar nga studio e avokatisë “Gërmenji”, shoqatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri në vlerën 4.230.000 Lekë, ndërkohë nga përgjigja e DRT Tiranë rezulton se subjekti Vladimir Gërmenji, me NUIS K (***) për periudhën 2012 – 2016 ka dalë me humbje totale rreth 688.053 Lekë;

- Mungon dokumentacioni i plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të shumës 2.000.000 Lekë dhuruar në vitin 2019 shtetases M.S. nga shtetasi G.S. (babai i saj), e përdorur si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 100 m2 në Tiranë, pasi referuar ISSH për periudhën 2002 – 2016 rezulton se ky shtetas ka përfituar të ardhurat nga pagat në shumën totale rreth 4.790.000 Lekë dhe prej vitit 2016 përfiton pension pleqërie, por nuk ka informacion lidhur me shpenzimet e kryer nga ky shtetas në këtë periudhë;
- Si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 100 m2 në Tiranë është deklaruar se janë përdorur dhe të ardhurat nga pagat e E.G. dhe nga biznesi i bashkëshortes së tij, M.S., ndërkohë referuar ISSH rezulton se E.G. ka realizuar të ardhura nga pagat për periudhën 2007 – 2018 në shumën rreth 2.379.665 Lekë; shtetasja M.S. për periudhën 2013 – 2018 në shumën totale rreth 1.509.688 Lekë. Total të ardhura rreth 5.637.124 Lekë, nga e cila nis zbresim shpenzimet e konsumit familjar kjo shumë ulet ndjeshëm (nuk ka informacion për momentin kur kanë filluar bashkëjetesën dhe nëqoftëse kanë ose jo fëmijë), shpenzimet e konsumit familjar për 1 person për periudhën 2007 – 2018 janë në shumën totale rreth 2.215.714 Lekë;
- Mungon dokumentacioni i plotë justifikues ligjor për burimin e shumës 900.000 Euro paguar për apartamentin e banimit me sipërfaqe 100 m2 në Tiranë;
- Mosdeklarimi i detyrimeve në llogarinë rrjedhëse me gjendje 3 Euro dhe në llogarinë e kastës së kreditit në shumën – 922.12 Euro nga shtetasi E.G. të konfirmuara nga FiBank;
- Mosdeklarim i detyrimit në shumën 40.000 Euro ndaj shtetases S.B. si rrjedhojë e kontratës së premtim shitje nr. (***) , datë 07.01.2019 është trajtuar tek apartamenti me sipërfaqe 100 m2;
- Është i paqartë burimi financiar i përdorur nga shtetasi E.G. për transaksionet në ABI Bank dhe për transaksionet e konfirmuara nga DPPP.

45. Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mbi gjetjet e sipërcituara, është njoftuar kandidati Vladimir Gërmenji në datë 28.05.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

46. Kandidati Vladimir Gërmenji me datë 03.06.2019 ka dorëzuar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi parashtrimet dhe akte që mbështesin qëndrimin e tij mbi raportin e kontrollit të pasurisë. Ndër të tjera ai ka sqaruar se:

- Qarkullimi për vitet 1998 – 2006 është në total në vlerën 17.900.000 Lekë. Nga këto tatimi i thjeshtuar i paguar është 700.000 Lekë dhe pagesa për sigurimet shoqërore është 492.912 Lekë për vitet 1998 – 2007. Kjo do të thotë se fitimi nga veprimtaria e avokatit për periudhën 1998 – 2007 ka qenë 16.707.080 Lekë;
- Xhiroja e deklaruar në organet tatimore ka qenë një parashikim me përafërsi i xhiros që mundet të bëhej gjatë vitit dhe se xhiroja në të vërtetë mundet të ketë qenë më e madhe dhe se referuar këtyre të dhënave fitimi i realizuar ndër vite është i justifikuar;
- Shuma prej 600.00 Lekë është kursyer nga puna e ligjshme e kandidatit dhe bashkëshortes së tij në Shkodër, ku kandidati ka punuar si hetues dhe bashkëshortja e tij si infermiere;
- Në lidhje me fitimin e realizuar me të cilin janë blerë dy apartamentet, respektivisht me sipërfaqe 50.7 m2 dhe 46.13 m2, kandidati ka sqaruar se apartamentin me sipërfaqe 50.7 m2 kandidati i ka blerë në vitin 2001 për vlerën 1.900.000 Lekë dhe se burimi ka qenë fitimi i realizuar nga aktiviteti i avokatit dhe se apartamenti me

sipërfaqe 46.13 m2 është blerë në fund të vitit 2005 në vlerën 1.800.000 Lekë dhe se sërish të ardhurat janë siguruar nga aktiviteti i avokatit;

- Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 62.37 m2, i blerë në fundin e vitit 2007 në shumën 2.000.000 Lekë, burim i krijimit të të ardhurave ka qenë kredia e marrë në vlerën 30.000 Euro nga NBG Bank sh.a., sipas kontratës së kredisë dhe hipotekimit;
- Apartamenti me sipërfaqe 74 m2 i ndodhur në Vlorë dhe i blerë për shumën 4.000.000 Lekë është blerë pjesërisht nga kredia 30.000 Euro e marrë nga NBG Bank sh.a. dhe pjesa tjetër e të ardhurave është marrë nga fitimet e krijuara nga ushtrimi i avokatisë;
- Në lidhje me blerjen e apartamentit me targa (***) sqarohet se shitësi dhe blerësi janë në lidhje krushqie që në vitin 2009 dhe se automjeti është blerë në vitin 2010 dhe se nga kjo lidhje është neglizhuar lidhja dhe formalizimi i kontratës. Kandidati sqaron se mospasqyrimi i saktë i vlerës dhe i shpenzimeve doganore ka ardhur si pasojë e kalimit të kohës së gjatë dhe një harrese të pakujdesshme. Kandidati sqaron se në këtë kohë të ardhurat i ka pasur të mjaftueshme për të blerë automjetin dhe për të paguar edhe shpenzimet doganore të tij;
- Lidhur me shumën e dhuruar prej 2.000.000 Lekë në vitin 2019 sqarohet se pensioni i babait të Znj. M.S. është 28.000 Lekë dhe se këto të ardhura ndër vite mjaftojnë të justifikojnë shumën e dhënë me dhurim vajzës dhe se provohet nga banka Credins sh.a. se në vitin 2017 ai ka tërhequr shumën 1.500.000 Lekë, duke konfirmuar faktin se ka pasur kursime;
- Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të kartës së kreditit të djalit, E.G.i, kandidati sqaron se mosdeklarimi i kartës dhe shpenzimeve për të ka ardhur si pasojë e neglizhencës dhe mendimit se nuk është shumë e rëndësishme dhe se është e paqëllimshme;
- Lidhur me mosdeklarimin e shumës 40.000 Euro të shtetases znj. S.B. për rrjedhojë të kontratës së premtim shitjes së apartamentit 100 m2, kandidati ka sqaruar se ky detyrim është pasqyruar në formularin e pasurisë së djalit, E.G., ku pasqyrohet se do t'i paguhet shtetases në një moment tjetër me këste;
- Lidhur me konstatimet e ILDKPKI për deklarimet në vitet 2013 dhe 2015 për të ardhurat nga fshati SOS, kandidati sqaron se konstatimet janë të drejta por se është harruar të deklarohet një faturë në vlerën 100.000 Lekë e vitit 2013 dhe një faturë në vlerën 50.000 Lekë e vitit 2015. Këto mosdeklarime janë harresë, vijon ai, dhe nuk ka asnjë qëllim për t'iu shmangur tatimit;
- Lidhur me konstatimet e ILDKPKI mbi qarkullimin e vitit 2015 ka një gabim material në përlllogaritjen që ka bërë ky organ, pasi nuk është shuma 1.450.567 Lekë, por është shuma 908.427 Lekë dhe se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk duhet ta marrë parasysh këtë konstatim;
- Lidhur me mosjustifikimin e shumës së dhuruar djalit prej 3.000.000 Lekë për blerje apartamenti janë tërësisht të justifikuara, pasi të ardhurat nga puna si avokat për periudhën 2012 – 2016 kanë qenë të mjaftueshme;
- Lidhur me mosjustifikimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 100 m2, kandidati ka deklaruar se djali i tij dhe shtetasja Znj. M.S. bashkëjetojnë dhe se kanë prenotuar apartamentin i cili përfundon së ndërtuar në vitin 2020 dhe se të ardhurat janë shumat e dhuruar nga kandidati dhe të krijuara nga puna e tij e ligjshme dhe të ardhurat nga puna e bashkëjetueses dhe biznesi i saj privat, të ardhura këto që rezultojnë të mjaftueshme për të përballuar këtë shpenzim. Kandidati ka sjellë në vëmendje se deri në vitin 2018 çifti kanë jetuar në shtëpitë e prindërve dhe se nuk kanë pasur shpenzime dhe se të ardhurat që kanë përfituar nga puna i kanë kursyer;
- Mungesa e dokumentacionit të të ardhurave të djalit nuk mundet të shërbejë si fakt për të konkluduar se ka shkelje, për sa kohë të ardhurat janë gjeneruar nga të ardhurat e

kandidatit dhe se marrëdhënia e posaçme baba – bir ka kushtëzuar këtë mënyrë bashkëpunimi;

- Lidhur me transaksionet e kryera pranë NBG Bank sh.a. nga djali, Z. E.G., kandidati sqaron se, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, ato nuk mbaheshin mend dhe se në formularë është pasqyruar vetëm pasuria ekzistente në momentin e përpilimit të tyre. Këto veprime bankare janë depozita të kryera në periudhën Korrik – Shtator 2012, ku një pjesë e të ardhurave janë kursime të djalit dhe se pjesa tjetër ishin kursime nga puna si avokat. Këto depozita janë realizuar me qëllim që të jetë sa më i besueshëm për të përfituar vizën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe se shumat janë tërhequr në vitin 2012;
- Pasaktësitë dhe mangësitë në mënyrën e plotësimit të deklaratës dhe formularëve të deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave ka ardhur si pasojë e mungesës së eksperiencës në plotësimin e tyre, harresës së disa të dhënave dhe dokumenteve, kohës së gjatë të përfshirë në informacion dhe kohës së shkurtër në dispozicion për të përpiluar deklaratën;
- Kandidati ka kërkuar përfundimisht nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që të konkludojë se deklaratimet e pasurisë të tij dhe të subjekteve të lidhura janë të plota dhe të mbështetura në ligj, ndryshe nga sa ka konkluduar ILDKPKI.

47. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Vladimir Gërmenji në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi, si dhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur nga kandidati Vladimir Gërmenji.

48. Nga analiza e akteve, të dhënave dhe gjetjeve Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se subjekti nuk ka bërë deklaram të saktë në ILDKPKI dhe këtë fakt ai e pranon edhe vetë në shpjegimet e tij. Kështu për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës në datë 05.05.2009, kandidati deklaroi si burim kredinë bankare e cila rezultoi të ketë pasur si destinacion të saj, sipas përmbajtjes së saj, blerjen/rikonstruksionin e një banese tjetër, të blerë në datë 08.12.2007. Kandidati ka deklaruar në shpjegimet e tij se ky deklaram është gabim njerëzor i shkakuar edhe nga mospasja e kontratës së kredisë bankare.

49. Por nga ana e subjektit, edhe në rast se pranohet se jemi përpara një gabimi njerëzor, nuk shpjegohet fakti se përse e gjithë shuma e kredisë i ka kaluar personit juridik D. sh.p.k., i cili është subjekti që i ka shitur banesën në Linzë, dhe jo personit juridik, i cili ka shitur banesën në Vlorë, A. sh.p.k. Këshilli mban parasysh faktin se midis këtyre dy personave juridikë nuk vërtetohet ndonjë lidhje ose marrëdhënie juridike.

50. Këshilli konstaton se, edhe në rast se merren të mirëqena shpjegimet e kandidatit, pra se kredia e mbetur pas shlyerjes së apartamentit në Linzë, ka kaluar si pagesë për banesën në Vlorë, ai nuk provon kalimin e kësaj diference në favor shoqërisë A. sh.p.k. Po kështu, Këshilli konstaton se kandidati nuk vërteton se ka bërë ndonjë pagesë nga kursimet e tij si avokat për pjesën e mbetur të detyrimit ndaj A. sh.p.k. (pra pjesa që nuk mbulohej nga mbetja e kredisë). Përkundrazi, nga të gjitha aktet si dhe nga deklarimi i kandidatit rezultoi se çmimi i është paguar A. sh.p.k. jashtë zyrës noteriale dhe jashtë sistemit bankar.

51. Këshilli vlerëson se, për më tepër, edhe në rast se do të pranoheshin shpjegimet e kandidatit për këtë pjesë të pasurive që disponon, ai duhet të mbante parasysh detyrimin se kredia bankare nuk mund të përdoret për një destinacion të ndryshëm nga ai që është miratuar pa u marrë më parë pëlqimi i kredidhënësit. Gjithashtu Këshilli vlerëson se duhet të mbahet parasysh edhe fakti se ka një distancë kohore të konsiderueshme midis blerjes së dy apartamenteve, i pari është blerë në datë 08.12.2007 dhe i dyti është blerë në datë 05.05.2009 dhe se gjatë gjithë kësaj kohe kandidati ka shlyer rregullisht këstet në favor të kreditorit bankar. Për rrjedhojë rezulton se kandidati nuk ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës.

52. Këshilli vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

53. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatit Vladimir Gërmenji është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i ligjit nr. 115/2016, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

54. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Vladimir Gërmenji, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 dhe shkronjës “a” të pikës 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit Vladimir Gërmenji, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Vladimir Gërmenji.
3. Kandidati Vladimir Gërmenji ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

